

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Avdi Dinaj dhe Valdete Daka, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale të të dënuarit I. I. nga Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale shmangie nga tatimi, nga neni 249 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, P.nr.238/2009 datë 21.3.2014, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PAI .nr. 659/2014 datë 5.11.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur më 9 mars 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit I. I., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, P.nr.238/2009 datë 21.3.2014, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PAI .nr. 659/2014 datë 5.11.2014.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, P.nr.238/2009 datë 21.3.2014, i dënuari I. I. është shpallur fajtor për veprën penale shmangie nga tatimi, nga neni 249 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK dhe për këtë veprë penale është gjykuar me dënim me gjobë

në shumë prej 3.600 (tremijëegjashtëqind) € të cilat është i detyruar t'i paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e në rast të mospagese, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgu, ku për çdo 20 € të filluar i llogaritet një ditë burgimi. Është detyruar i dënuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe 20 € në emër të paushallit gjyqësor, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. E dëmtuara Administrata Tatimore e Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Prishtinë, PAI nr. 659/2014 datë 5.11.2014.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit I. I., E. P., av. nga Vitia, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit panel, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen, çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza apo akuza të refuzohet për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr.33/2016 datë 22.2.2016 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e çështjes konform dispozitave të neneve 425 par. 1 dhe 426 par. 1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se me rastin e paraqitjes së ankesës, kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, ka paraqitur kërkesë që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij të njoftohen për seancën e kolegjit pranë Gjykatës së Apelit, se shqyrtimi gjyqësor pranë gjykatës së shkallës së parë ka filluar sipas dispozitave të Kodit të procedurës penale i cili ka qenë në fuqi gjer më 31.12.2012, ndërsa shqyrtimi i mëvonshëm ka filluar dhe është përfunduar sipas dispozitave të Kodit të Ri të procedurës penale që është në kundërshtim me dispozitën e

nenit 541 të KPPK-së dhe mendimit parimor të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 56/2013 datë 23 janar 2013.

Po ashtu, në kërkesë thekson se obligimi i pagesës së tatimit është në periudha kohore prej 3 muajsh njashtu që po të llogaritej tatimi i papaguar për vitin 2003, do të ndërronte cilësimi juridik i veprës penale respektivisht do të arrihej parashkrimi absolut i ndjekjes penale, duke konsideruar se Gjykata e Apelit gabimisht ka vlerësuar se obligimi i pagesës së tatimit ka qenë gjer më 10.11.2004 ndërsa sipas shkresave të çështjes rrjedh se detyrimet tatimore janë prej 1.4.2003 gjer më 30.9.2004 e që lejohet pagesa gjer në të pesëmbëdhjetin e muajit vijues (gjer më 15.10.2004).

Qëndron pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit se shqyrtimi gjyqësor ka qenë i caktuar dhe shtyrë sipas dispozitave të Kodit të procedurës penale që ishte në fuqi gjer më 31.12.2012, ndërsa dispozitat e reja të Kodit të procedurës penale hynë në fuqi nga 1 janar 2013.

Nga shkresat e çështjes vërtetohet se shqyrtimi gjyqësor i datës 12.2.2013 ka filluar sipas dispozitave të reja të Kodit të procedurës penale ndërsa nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se as i dënuari e as mbrojtësi i tij nuk kanë kundërshtuar fillimin dhe përfundimin e kësaj çështjeje penale sipas dispozitave të Kodit të Ri të procedurës penale penale.

Po ashtu, vlen të theksohet se edhe ankesa e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është paraqitur sipas dispozitave të reja të Kodit të procedurës penale ku dhe Gjykata e Apelit në rastin e vendosjes sipas ankesës së mbrojtësit të të dënuarit çështjen e ka vendosur sipas dispozitave të reja të Kodit të procedurës penale të hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

Mirëpo, vlen të theksohet se këto pretendime vetëm në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë theksohen, por, kjo Gjykatë konstaton se procedura e filluar sipas dispozitave të Kodit të procedurës penale, i cili ka qenë në fuqi gjer në 31.12.2012, është dashur të përfundojë sipas të njëjtave dispozita ligjore mirëpo, kjo shkelje është e natyrës relative e cila nuk ka ndikuar në marrjen e një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm dhe se me zbatimin e dispozitave të reja të Kodit të procedurës penale, i dënuari nuk është sjellë në ndonjë pozitë më të pavolitshme e as që pozita e tij në cilësinë e të akuzuarit ka qenë e përkeqësuar.

Po ashtu, qëndron fakti se me rastin e paraqitjes së ankesës, mbrojtësi i të dënuarit në ankesë ka kërkuar që konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, i dënuari dhe mbrojtësi i tij të njoftohen për seancën e kolegjit pranë gjykatës së shkallës së dytë, mirëpo meqë janë zbatuar dispozitat e reja të Kodit të procedurës penale, njoftimi për seancën e kolegjit, palëve u dërgohet vetëm në rastet kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim efektiv.

Pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë përkitazi me parashkrimin absolut të ndjekjes penale, përveç arsyeve të theksuara nga gjykata e shkallës së dytë, vlen të theksohet se bazuar në shkresat e çështjes, qartë vërtetohet se vepra penale shmangie nga tatimi ka filluar të kryhet gjatë vitit 2003 ndërsa ka përfunduar në vitin 2004 e që nga kjo qartë vërtetohet se bëhet fjalë për një vepër penale të vazhduar shmangie nga tatimi, ndërsa në rastet kur bëhet fjalë për vepër penale të vazhduar vjetërsimi fillon nga koha e përfundimit të veprës penale e që në rastin konkret nuk bëhet fjalë për parashkrimin e veprës penale siç pa bazë pretendohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Nga të theksuarit më lartë e konform dispozitës së nenit 437 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

PML.nr. 50/2016 datë 9 mars 2016

Procesmbajtës,
Sherif Krasniqi

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa